

854-32

M 70

ARISTOTEL MICI

Midis gjelbërimesh



85H-32

M 70

5

ARISTOTEL MICI

MIDIS GJELBERIMESH

(Përshkrime)

~~49407~~

LIBRARI I UTËKËS E SHIETËS
GJYKËS

2739

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PËRSHTYPJET E PARA

Çdo pranverë e re, si kudo, edhe në Myzeqe përtërin natyrën, shton energjitë e njerëzve, gjallëron dhe më shumë ëndrrat dhe shpresat. Pranvera e vitit 1968 për bujqësinë e rrethit të Fierit solli me vete vrulle dhe dëshira të mëdha. Tok me aromën e ugareve e të luleve bujqve u erdhën nëpër kooperativat e tyre edhe mësimet e partisë e të shokut Enver Hoxha për intensifikimin e mëtejshëm të bujqësisë, për shtimin e rendimenteve.

Myzeqarët e rilindur rrihnin mendime, për t'i gjetur sekretet tokës, për të përsosur më mirë mjeshhtërinë e tyre. U hodh parulla: «Rendimentet e vitit 1970 t'i marrim në 1968». Me këtë parullë i zinte gjumi bujqit e rrethit të Fierit dhe me këtë zgjohehin e vinin në punë. Këto fjalë i dëgjoje në shtëpira, në ara, në vatrat e kulturës.

Për këtë mendonin edhe bujqit e kooperativës së bashkuar «Apolonia» të Pojanit në rrethin e Fierit.

Shoku Enver, duke folur për bujqësinë në Kongresin e Pestë të Partisë, çmoi shumë «shembujt e shkëlqyer të rendimenteve, të arritura nga kooperativa e Pojanit në rrethin e Fierit». Ata kanë arritur suksese. Por a mund të dehen me to dhe të rrinë

në vend? Jo! Ata do t'i shumëfishojnë sukseset, do t'i shtojnë më shumë rendimentet. Dhe lufta për rendimente më të larta filloi në fushatën e mbjelljeve pranverore.

E vizitova këtë kooperativë në muajin prill. Punonjësit e çdo sektori ishin në garë për të mbjellë pjesën më të madhe të bimëve brenda atij muaji.

Në rrugën kryesore të kooperativës ka shumë lëvizje. Aty shkojnë kooperativistët, nxënësit, ekskurSIONISTAT e lokaliteteve përreth. Në këtë rrugë kanë shkuar me qindra e qindra autobuza turistike, që sjellin vizitorë nga çdo anë e atdheut, me qindra vettura, të cilat sjellin turistë të huaj. Në të hyrë të Pojanit plepat ja lënë vendin kavakëve të gjatë, ku ziejnë cicërimat e zogjve. Të dyja anët e rrugës janë të veshura me trandafila e me lule të shumëngjyrshme, prandaj këtë rrugë e quajnë «Rruga e luleve». Në këtë rrugë plot me trandafila kryqëzohen romantikat: jehona e traktorëve dhe zëri i radjove me aromën e trandafilave dhe këngën e bilbilave. «Pranvera në kooperativën e bashkuar «Apolonia» është e bukur plot me lule ngjyra-ngjyra dhe të magjeps me erërat e bimëve, me aromën e akacjeve, me freskinë e lulekuqes. Sa të bukur e kanë bërë fshatin e tyre të ri pojanakët!

Çdo njeriu, që vjen së pari këtu, mendja i shkon dhe te qyteti i vjetër i Apolonisë, ku gërmonjësit zbulojnë çdo vit objekte të antikitetit. Vizitorët, para se të njihen me monumentet dhe pamjet e qytetit, shkojnë te lisi plak pranë manastirit bizantin. Atje për ditë mblidhen grumbuj njerëzish prej çdo kra-hine që të dëgjojnë arkeologun. Shkova dhe unë. Arkeologu, kur flet për lavdinë e qytetit antik, mbushet plot pasion.

— Sa i vjetër është ky qytet? — pyeti një i huaj për «Qytetin e madh dhe hijerëndë».

— Është themeluar më 588 p.e.r. — u përgjegj arkeologu.

E lamë ciceronin bashkë me turistat atje te lisi. U ngjitëm në kodrën më të lartë të veshur me ullinj. Nga të katër anët shtrihej Myzeqeja si një det i gjelbëruar. Ndën këmbët e kodrës së Apolonisë zgjerohet kënetat e Hoxharës, që arrin deri në Boçavë e në Laçan pranë Povelçës. Në fund të kënetës, ku ngrihen kodra ranore dhe ndahet gjoli me detin, duket hidrovori i Povelçës, që thith si një përbindsh me gjasthtë gryka 36 m^3 (metër kub) ujë në sekondë. Dikur kjo kënetë ishte fole mushkonjash...

Anës kodrave të Apolonisë si një arterie jetëdnënëse për arat gjarpëron kanali ujitës Vjosë-Levan-Fier. Nga kanali i madh dalin pastaj me dhjetëra të tjera më të vogla, që shpërndahen nëpër parcela si damarët nëpër trup. Në Havaleas kanali ngjitet akoma dhe më lart. Elektropompat e hidrovarit, që janë ngritur në shpinë të kodrës, e ngrehin ujin përpjetë, e ngjisin disa metra më lart. Kështu ujët niset në drejtim të kodrave të Radostinës, për të vaditur gjithë fshatrat rreth Fierit.

Që atje, nga pika më e lartë e Apolonisë, njeriu shikon gjithë horizontin e Myzeqesë. Si ishuj bukurie janë vendosur në detin e gjelbërimit shtëpitë e reja të fshatrave. Këto fshatra dikur i kishin shtëpitë të rralla e të shpërndara, tashti janë bashkuar e kanë marrë pamjen e lagjeve qytetare. Shtëpitë e reja presin nga dita në ditë me dëshirë të madhe dritën elektrike. Këto janë përshtypjet e para që ka njeriu në qëndrimin e tij të shkurtër në kooperativën e bashkuar «Apolonia». Po në qoftë se rri për një

kohë të gjatë e fute në shpirtin e njerëzve të punës, atëhere do të kuptosh dhe më mirë se janë pikërisht këta njerëz me vullnet të hekurt, që e bëjnë panoramën e kooperativës aq tërheqëse, aq të bukur.

Njeriu i thjeshtë, i çliruar nga çdo ndrydhje, myzeqari i rilindur, po bën mrekullira në arat e kooperativave. Myzeqarin Partia e ngriti në radhën e gjithë njerëzve të tjerë, e bëri zot të tokës, zot të vetes; e çliroi nga zgjedha e beut dhe nga druajtja e paragjykimeve. Partia, duke çliruar myzeqarin nga ana klasore, çliroi dhe energjitë e tij fizike dhe mendore. Me qindra traktorë enden në ara dhe ata që i drejtojnë janë myzeqarë. «Me dhjetëra ekskavatorë mbushin kovat e mëdha nëpër kanale dhe ata që i lëvizin këta «lejlekë të hekurt» janë myzeqarë. Me qindra agronomë, zooteknikë, veterinerë, brigadierë punojnë nëpër fusha. Dhe të gjithë këta janë bijtë e etërve të shumëvujtur...

Sot myzeqari nuk di vetëm të lërojë dhe të prodhojë, ai është bërë mjeshtër në shumë drejtime. Po të vije në rrugën kryesore të Pojanit disa vjet më parë, kridheshe në baltë, sot ajo është shtruar me kalldrëm. Në të dy anët e saj sheh shtëpitë me themele, të lyera jashtë e brenda me gëlqere, pastërtia dhe ajrisja e brendshme të japin në këto familje përshtypjen e një lagjeje qyteti. Kjo tregon se niveli i jetesës në kooperativë ngrihet vazhdimisht. Mbrezat e mira vijnë e shtohen kur buçet radjoja, kur zjen kafeja me furnelë elektrike, kur hekurosit vajzat bluzat e bardha me hekurin elektrik...

Këto mrekullira njerëzit e thjeshtë i ngritën vetë me duart e tyre, nën udhëheqjen e Partisë. «Die-lli i partisë na nxori në jetë» thonë të gjithë në Pojan.

SHQIPONJAT E FUSHËS

Kështu i thërrasin dy brigadjeret e reja, Lirinë dhe Aristenë. Të dyja janë natyra të gjalla plot energji dhe dashuri për punën. Nga mëngjezi në mbrëmje ato kontrollojnë, punojnë e udhëzojnë ndër ara. Të dyja kanë përkrahur inisiativën e Troshanit për të bërë ditë pune krahas drejtimit të brigadës. Në punën fizike shkojnë bashkë me shoqet pa u ndruajtur nga shati dhe nga drapëri. Sekretari i partisë, Gori, na tregoi se në fillim pati ngurrime për të vënë në krye të brigadës vajza. Shumica fitoi. Me kalimin e muajve njerëzit u bindën se edhe femrat bëjnë punë si burrat bile edhe më mirë.

Kur shikon Lirinë, këtë vajzë të thjeshtë pojanake, që drejton një nga brigadat e dalluara në kooperativën «Apolonia» shikon myzeqaret e rilindura nga mësimet e Partisë. Liria s'flet për vete, po për ugaret, për bimët, për rezultatet.

Po në qoftë se bimët e arave janë aq të mira, është puna e brigadës që drejton Liria e mirë. Liria nuk është vetëm një punëtore dhe organizatore e zonja, ajo në radhë të parë është një specialiste e zonja. E njeh agroteknikën dhe mundohet ta futë në jetë. Gati e gjithë brigada që drejton Liria punon në par-

celat eksperimentale. Liria e di tashti se edhe revolucioni tekniko-shkencor edhe në bujqësi s'bëhet vetëm nga disa. Ajo mundohet të mësojë vetë, të eksperimentojë, dhe mendimin e vet e sqaron me anëtarët e brigadës, duke kërkuar prej të gjithëve pjesëmarrje aktive. Brigada, që në fillim të fushatës së mbjelljeve pranverore, vendosi të plehërojë më së miri tokën, sipas rregullave agroteknike. Përveç plehut të stallave të kooperativës, brigada gjeti rezerva të mëdha plehu organik në stallat e bagëtive personale. Me kujdesin më të madh shpërndanë nëpër ara plehun kimik të superfosfatit. Gjatë periudhës së lërimit kjo brigadë bëri dhe nitrifikimin e tokës. Në muajin prill u mobilizuan gjithë forcat, për të mbarruar mbjelljen e misrit me shatë dhe në fole katrore. Të mbjellësh të gjithë sipërfaqen e misrit me shatë dhe në fole katrore është vështirë por kjo duhej bërë patjetër për të shumëfishuar rendimentin. Që të bëhet realitet një dëshirë e tillë duhet të punosh pa u kursyer, të mos marrësh parasysh interesin personal dhe rehatinë personale. Të gjitha skuadrat ishin në garë në kohën e mbjelljeve. Në ballë të punës qëndronte skuadra e të rinjve me Fanin e palodhur në krye.

Skuadrën e Fanit e pashë të renditur pas një spangoje të piketuar. Në çdo 60 cm. ishte vënë një shenjë e kuqe. Në ato vende, në atë largësi hapeshin gropat. Puna në drejtim të spangos të piketuar ikte zinxhir. I pari hapte gropën me shatë 30 cm. të thellë dhe 35 cm. të gjerë, i dyti, hidhte në çdo gropë plehun organik të përzier me dhe. Pas tij vinte një vajzë. Ajo hidhte në gropat e mbjelljes 10 gram superfosfat të përzier me sulfatpotas. I katërti hidhte në gropa nitratin e përzier me dhe. Në fund Liria

mbillte tre-katër kokrra misër për çdo gropë të hapur...

— Pse nuk e mbillni me parmendë por me shatë
— e pyeta Fanin.

— Se duam të dyfishojmë prodhimin, duam të zbatojmë porosinë e Kongresit të Pestë «që të plehërojmë bimën dhe jo tokën».

— Ç'është ndryshimi midis mbjelljes me fole katrore dhe me parmendë — i pyeta anëtarët e kësaj skuadre të përparuar.

— Mbjellja me fole katrore ka shumë anë pozitive — m'u përgjegj Liria:

E para: sigurojmë bimën për çdo gropë. Ne hedhim nga katër kokrra, një nga të cilat do të mbijë patjetër.

E dyta: kështu plehërojmë bimën dhe jo tokën, i sigurojmë çdo bime plehun që i nevojitet, kurse me parmendë do ta hedhim plehun edhe atje ku s'ka bimë.

E treta: kursejmë plehun, kursejmë atë pleh që e hedhim atje ku s'kishte bimë në mbjelljen me parmendë.

E katërta: duke kursyer plehun zgjerojmë sipërfaqen e plehëruar.

E pesta: dhe po të na mbetet ndonjë vend pa bimë, e diktojmë më shpejt dhe e kojmë me shatë.

Së fundi: shërbimet bimës i bëhen më me saktësi e më mirë.

Është kënaqësi kur dëgjon këto kooperativiste të reja që spjegojnë problemet e agroteknikës sikur të jenë agronomë. Kur bisedon me anëtarët e skuadrës së Fanit e kupton se edhe në bujqësi çështjen

e revolucionit tekniko-shkencor e kanë marrë në duart e tyre masat e gjera të kooperativistëve, sidomos të rinjtë. Rinia jonë në çdo fushë të jetës po sulmon përpara. Ajo ecën në rrugën e revolucionit tekniko-shkencor edhe në bujqësi pa druajtje, duke pasur në dorë flamurin e PPSH.

ARISTEJA

Brigadjeren e brigadës së X e quajnë Ariste. Ajo tanimë ka një përvojë të mirë bujqësore. Me punën e saj, me mendimet e saj, ajo ka mundur të tërheqë drejt së resë gjithë anëtarët e brigadës. Kishte njerëz që nuk besonin në plugimet e thella. «I prishet tabani tokës» — thoshin. Po të rinjtë e brigadës dhe brigadierja nuk u mposhtën.

Edhe Aristeja e bën rregullisht punën fizike në prodhim. Në fillim disa tundnin kokën në shenjë mosbesimi e thoshin: «puna e brigadjerit u bë e vështirë për burrat e jo për gratë». Po Aristeja, si shumë shoqe të saj, ja doli mbanë detyrës. Puna fizike në ara e ka afruar shumë atë me anëtarët e brigadës. Besimi i patundur te kolektivi i brigadës dhe te forcat e saj është karakteristikë themelore e Aristesë. Sigurinë në vetëvete ajo e fitoi në punë dhe në lexime. Brigadierja është edhe një pjesëtare aktive e revolucionit tekniko-shkencor në bujqësi. Këtë vit Aristeja u muar me një eksperiment shumë të rëndësishëm: Mati forcat e brigadës së saj në një tokë ish-moçalore. Është fjala për një sipërfaqe të mirë toke, që u përfitua nga tharja e kënetës së Hoxharës, e cila u përfshi në tokat e kooperativës. Meqë

vitin e parë kjo tokë nuk dha rezultate të mira, disa thanë:

— Ta lëmë për kullotë.

— S'bën bimë ajo — u hodh ndonjë tjetër.

— Dhe në qoftë se e rrit, ajo tokë e lë shterpë bimën — dëgjoheshin fjalë.

Një i shkuar nga mosha tha:

— Është tallabak, more shokë, është tallabak.

— S'ka taban kjo tokë, — tha një tjetër.

— Vetëm dërnok dhe çol rrit ajo!

Të rinjtë e brigadës X dhe brigadjerja hodhën parullën: «ta kthejmë tokën kënetore në tokë buke».

Anëtarët e brigadës X ju përveshën punës me ngulmë, duke studjuar dhe përdorur agroteknikën. Sot çuditën njerëzit me bimët e tokës kënetore. Ajo tokë u quajt «e keqe» «tallabak i fortë» «shterpë» u shndrua në parcela në formë kurriz peshku. Toka moçalore u përtërit. Parcelat e kësaj toke nga të fundit që ishin u vunë në radhën e të parave.

Ja ç'bëri brigada për të përmirësuar këtë tokë: Gjatë muajve të dimrit skuadra e kullimit kishte treguar kujdes dhe gadishmëri të përhershme. Toka që kulluar aq mirë, sa që ujët s'pati qëndruar as në vijat kulluese. Tokës kënetore i bënë plehërimin e nevojshëm. Për ta pasuruar përbërjen e saj, i bënë tre nitrifikime me dozën 1 kv. për hektar, duke e hedhur çdo dozë në krye të pesëmbëdhjetë ditëve.

Që të kuptohej dobia e plehimit të rregullt, anëtarët e brigadës lanë me qëllim një copë të vogël pa e nitrifikuar me dozën e dytë. Të gjithë e panë ndryshimin midis parcelës së nitrifikuar me dozën e dytë dhe asaj ngastre.

Kjo provë i bindi anëtarët e brigadës së X për

dobinë e nitratit të amonit me doza të caktuara e në afate të afërta.

Tokës para mbjelljes ju bën dy punime të thella, dy diskime dhe dy lesime. Parcelat u lëruan dhe u mbollën në formë kurriz peshku. — Çfarë dobie i sjell kjo tokës dhe bimës? — pyeta Aristenë. — E para, siguron kullimin e plotë në çdo periudhë lagështire dhe e dyta, në kohë thatësire, krijon mundësi të mëdha për ujitje të qetë dhe jo me përmbytje. Toka e mbjellë në formë kurriz peshku e thith ujin nga brazda kryesore, ashtu si buka e grurit thith qumështin...

— Po në rast se toka del argjilore? Kam marrë vesh se e tillë ishte ajo.

— Në qoftë se toka del argjilore dhe e bardhë, me kapilare të vogla, atëherë thithja e ujit nga toka paraqet vërtet vështirësi. Në raste të tilla është e nevojshme që nga brazda kryesore të hapim brazda të vogla në të dyja anët e kryesores. Kështu vepruam ne.

Grunoret e brigadës së Aristesë ishin shumë të mira. Kështu nga parcelat e braktisura u muarën rendimente të larta.

BASHKËPUNËTORËT SHKENCORË

Në Kongresin V të kooperativave bujqësore u shtrua drejt çështja e intensifikimit të bujqësisë, u tha se rruga e intensifikimit të mëtejshëm është rruga për revolucionarizimin e prodhimit bujqësor. Shtimi i shumëfishuar i pjellorisë së tokës lidhet në mënyrë të domosdoshme me thellimin e revolucionit tekniko-shkencor. Kjo çështje në kooperativën «Apolonia» është kuptuar drejt nga të gjithë. Në kooperativën «Apolonia» fshatarësia është kthyer në një forcë të madhe lëvizëse për revolucionarizimin e prodhimit bujqësor. I rëndësishëm është edhe fakti se numri i madh i kooperativistëve, që merren me kërkime, nuk eksperimentojnë vetëm ngastra të vogla. Ata kanë kaluar nga ngastrat e vogla eksperimentale në sipërfaqe të mëdha, pasi e kanë parë dhe kuptuar dobinë e punës, kur ka qenë e lidhur me agroteknikën e re.

Seminari shkencor dyditor në shkallë republike, i cili u mbajt në fillim të pranverës në kooperativën e Pojanit, është një shenjë e qartë e mobilizimit eksperimentonjës masiv, në fushën e bujqësisë. Rreth 150 të rinj dhe të reja u futën në një grazhdare të re me nga një fletore në xhep. Ishin eksperimento-

njësit e parë, bashkëpunëtorët e parë shkencorë, që vinin nga arat e fushave dhe të kodrave për të prurë rezultatet e kërkimeve të tyre bujqësore. Në këtë seminar çdo gjë dukej e re dhe origjinale. Auditori s'ka aromë kompensatoje dhe llustër mobilerish, ai ka erën e lëpushkës së misrit dhe të lules së diellit. Pjesëmarrësit janë njerëz të thjeshtë të fushave, që bartin me vete aromën e ugarit. Kumtesat e tyre nuk janë të shkruara me makinë. Njerëzit, që i përfytyrojnë bashkëpunëtorët shkencorë me mjekër, me kapele republikë, me cigare në gojë e shtëllunga duhani, do të çuditëshin si me sallën ashtu dhe me pjesëmarrësit e seminarit. Po sado që këta të rinj vijnë nga arat, sado që terminologjia e tyre është akoma e papërpunuar, metoda e tyre është e drejtë, e thellë e shkencore.

Ata suallën në fitoret e veta përvojën shkencore masive.

Pojanakët shkëmbyen në këtë seminar përvojën e tyre.

Një nga pjesëmarrësit në seminar që dhe Pashoja, bujk me përvojë të madhe. Duart e këtij kooperativisti plot kallo nuk përdorin mirë vetëm shatën e kazmën, por edhe lapsin e librin. Kumtesa e tij kishte të bënte me dózat e ndryshme të nitratit dhe të fosforit për parcelat e rendimenteve të larta. Plehrimin kimik Pashua e kombinoi me plehrimin organik. Nga njëra anë ai i jep rëndësi plehrimit, nga ana tjetër, nuk nënvlerëson aspak gjithë llojet e punimeve bujqësore. Pashua përgjithësoi me fjalët e tij në seminar përvojën e brigadës dhe të eksperimentimit kolektiv në ngastrën e posaçme për eksperiment. Këtë vit skuadra e të rinjve mori në parcelën eksperimentale prej 12 hektarësh 80 kv.

misër për hektar nga 40 kv. për hektar që mori vitin e kaluar në kulturën e misrit.

Me qëllim që të dyfishonin prodhimin e misrit në parcelën eksperimentale anëtarët e brigadës e bënë mbjelljen sa më shpejt dhe sipas agroteknikës së re, me plehrim në fole katrore. Në çdo gropë hodhën 1.5 kg. pleh organik të përzjerë me dhe, 4 gram nitrat. Misrit i bënë pesë ujitje, gjatë kohës së prashitjes dhe një plehërim suplementar me dozën 4 kv. për hektar, duke patur parasysh të plehronin bimën dhe jo tokën. Plehrimin e fundit e kryen në kohën e prashitjeve të vona. Ky plehrim i fundit suplementar, i cili përbëhet nga plehu i shpendëve dhe fekale të kompostuara, kryhet me anë të ujitjes. Mënyra e plehërimit është e thjeshtë. Para brazdave janë bërë vaska (gropa). Këtu hidhet plehu i kompostuar. Ujët, para se të futet në brazdë, merr me vete në vaskë plehun dhe, pasi të ketë përshkuar brazdën, vete në ugar edhe ushqen bimën.

Përvojë të madhe ka Pashua sidomos për bimën e pambukut. Para mbjelljes brigada ku punon ai i bën tokës dy plugime, dy diskime e dy lesime. Bimën e pambukut e prashit 4 herë. Prashitjen e kryen në interevale prej 10-12 ditësh. Për arësye të intervaleve të prashitjes së pambukut, Pashua ka eksperimentuar dy parcela. Njerës parcelë ja bëri prashitjen në afatin 20-22 ditë, kursë parcelën e dytë e prashiti në afatin 10-12 ditë. Për vjeljen e pambukut në brigadën e Pashos u bë një provë e thjeshtë, që ka rëndësinë e saj. U vunë në garë dy vajza. Njëra mblidhte pambuk të një kualiteti dhe e fuste atë në një xhep. Tjetra mblidhte pambuk të dy kualiteteve dhe e vendoste në dy xhepa të futës. Nga prova me peshë doli se ajo mbledhëse,

që voli një lloj pambuku dhe e futi në futë, kishte mbledhur më tepër se e dyta, që mbledhte dy kualitete në të njëjtën kohë. Vajza e parë provoi dhe vetëveten në kohë të barabarta: ajo mbledhi më shumë, kur vilte një lloj të vetëm pambuku, se sa kur voli dy kualitete në të njëjtën kohë. Në brigadë u vendos që sejcili të mbledhë vetëm një lloj pambuku. Një vjelje e tillë të jep dorë më shumë, të kursen kohën dhe të ndihmon për të mbledhur sa më tepër. Dhe cilësia e pambukut është më e mirë.

~~49407~~

IBRAME JUTEKA E SHIETIT
SHIETI

2739

M I T I

Miti ishte më i vjetri nga pjesëmarrësit e seminarit. Ai është një myzeqar i thjeshtë, s'i njuh terminologjitë e larta agroteknike. Po megjithëkëtë Miti tërhoqi vëmendjen e të gjithëve me urtësinë e tij: «Për mua — tha ai — është kënaqësi e madhe kur shikoj gjithë këta njerëz, që janë mbledhur për të biseduar rreth bujqësisë, rreth mjeshtërisë së bujkut, të cilit para çlirimit nuk i patën thënë kurrë usta. Falnderoj nga zemra Partinë dhe shokun Enver, që e ngritën kaq lart dhe zanatin tonë. Ne, dikur, të dashur të rinj, kemi qenë qorra me sy hapur, ashtu na kishte lënë ajo kohë e hidhur. Aq të prapambetur ishim në vitet e para pas çlirimit, sa që ndonjëherë mezi i kuptonim porosinë e partisë e të pushtetit në lidhje me tokën. Ja një shembull: Në vitet e para, pas çlirimit, Shqipëria e blinte me valutë nga jashtë vendit plehun kimik. Kuptohet fare mirë sa kushtonte ai pleh deri sa vinte nëpër fshatra. Po ne i.a dukej gjë e kotë, s'na mbushej mendja se ai pleh i bardhë na e shëndoshte tokën. Një shoku im nga Hoxhara tha: «O, po si gëlqere është ky» dhe e hodhi në një hendek të cekët mes gardhit. Pas një muaji miku im nga Hoxhara la mendjen kur

pa se hidhësi i atij hendeku pranë gardhit ishte rritur deri në brez. Atëhere ai mori edhe dheun me qerre nga hendeku dhe e hodhi në ugar.

Edhe pambukun nuk e deshnim ne në fillim: «E merr era dhe e bën fije fije si pëlthurë merimange» thoshnim. Kishte të tjerë, që nxirrnin të tjera fjalë, se gjoja «nuk e bën toka pambukun». Ndonjëri, kastile, që të mos binte e mbillte fare cekët e më të thatë. Nuk kaloi shumë kohë e bujqit u bindën për dobinë e pambukut. Nuk na thoshnin më teknikët bujqësorë për të mbjellë pambuk, përkundrazi, ne u luteshim të na jepnin sa më shumë farë. Çdo porosi e Partisë për ne ka qenë dritë, që na ka hapur sytë, na ka treguar rrugën e përparimit. Fjalimi i i shokut Enver mbi revolucionin tekniko-shkencor duhet të jetë një nxitje e madhe për të gjithë, me qëllim që t'i përvishemi punës me gjithë zemër, duke vënë në lëvizje jo vetëm krahët, por edhe mendjen».

Para ca kohe xha Mitin e gjeta duke mbledhur pambuk midis të rinjve. Në pushim ai u tha atyre: «Ta doni tokën e fshatit, ugaret, zanatin si veten tuaj. Balta e zezë e këtyre ugareve është brum, është bukë. Dikur ne punonim në këto ara, që ishin të beut, po me krahë të ftohta lëronim, sepse mbillnim e korrnim e nuk dinim ç'merrnim. Një herë mua dhe tim kunati na u mbush mendja ta linim bujqësinë e të gjenim jetë më të sigurt si hamenjë në portin e Durrësit. Me vete muarëm edhe një jorgan, që të flinim nga të na zinte nata. Punë nuk gjetëm. U kthyem me gisht në gojë, pa një lek në xhep. Për të ardhur e për të ngrënë rrugës, shitëm edhe jorganin».

Miti tani është thyer në moshë. Ai është rreth

gjashtëdhjetë vjeç. Është futur në atë fazë të jetës, kur njeriu quhet plak i ri. Po Miti i tillë ka për të qëndruar tërë kohën, se edhe kur të zbardhet fare ka për të qenë plak i ri. Në seminarin shkencor ai nuk përfaqësonte vetëm veten, Miti ishte në radhë të parë përfaqësonjës i një brezi të tërë myzeqarësh të shkuar nga mosha, por të rilindur nga shpirti. Tek Miti shikojmë përtëritjen shpirtërore të gjithë Myzeqesë. Bindja e tij për ngritjen e pjellorisë së tokës, për shtimin e rendimenteve, shprehet në këto fjalë të urta, që përdor dendur: «toka është si lopa, po i dhe, po e ushqeve, të ushqen». Miti ka besim të patundur te mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha. Ato mësimet e bëjnë Mitin të marrë pjesë në revolucionin tekniko-shkencor, të flasë me vrujllin e djaloshit e të punojë me energjinë e të riut midis gjeneratës së re. Miti eksperimentoi shtimin e rendimentit të misrit me anën e vaditjes me ujë të përzjerë me një përçindje urine. Në dukje ky eksperiment ngjan i thjeshtë, por edhe ai përmban brenda idenë e madhe të kohës sonë se edhe revolucionin tekniko-shkencor, si çdo revolucion, do ta bëjnë masat.

VRULL NËPËR ARA

Organizata bazë e partisë dhe drejtuesit e kooperativës «Apolonia» e kanë vlerësuar çdo inisiativë e mendim që i shërben prodhimit. Angazhimi që kanë marrë kooperativistët për të realizuar prodhimin e vitit 1970 në 1968 i ka vënë të gjithë në lëvizje. Drejtonjësit e kooperativës janë hedhur vetë në ballë të punës për të udhëhequr masën e kooperativistëve, për të shtuar prodhimin, për t'i marrë sa më shumë natyrës.

Kryetarin e kooperativës, shokun Ali, e gjetëm midis një brigade. Balli i tij me rrudha tregonte përqëndrim. Ai punonte dhe udhëzonte. Në porositë e tij shikoje krahas kujdesit për arën dhe shqetësimin për bimët. Thatësia kërcënonte gjelbërimin, rrezikonte prodhimin. Toka vende-vende kishte plasur si pëlçet buza e njeriut nga ethet. Fëshfërima e gjetheve të grurit i ngjante Aliut si një mërmërimë, si një thirrje për ujë. Të gjitha bimët e mbjella kanë ulur gjethet. Aliut i duket sikur i thonë «duam ujë». Në sytë e kaltër të kryetarit vezullojnë xixat e besimit të patundur se ata do të fitojnë mbi thatësinë.

— Nuk do ta presim më shiun. Duhet ta vaditim

dhe grurin! Ujët e Vjosës «do ta kapim prej gushe» dhe do ta fusim ndër arat me grurë... — i tha një kooperativist.

— Ke hak. Ashtu duhet bërë. Ta vaditim dhe grurin.

Aliu dhe kur ecën nëpër ara, kur shikon punën kërkimore-shkencore, kur punon vetë, mendjen e ka te plani revolucionar i këtij viti. Ai plan doli nga një diskutim i gjerë masiv me përpjekje mendimesh nëpër skuadra, brigada nga të gjithë anëtarët. Plan i studjuar në mënyrë kolektive tregoi fuqinë vitale të masës, rrugët dhe mundësitë e shumta që ka kooperativa për shtimin e prodhimit. Organizata e partisë e përkrahu angazhimin e masës dhe po e udhëheq me qartësi vrullin e saj, që ka shpërthyer nëpër ara.

Kryetarin e gëzon dëshira e kooperativistëve, që duan të marrin 85 kv. misër për hektar, që duan ta shtrijnë eksperimentin në gjysmën e tokës nën kulturë. Po me gjithë gëzimin që ka, me gjithë besimin e madh, ndonjëherë tek çlodhet, ai bie në mendime. Nuk thonë kot fare se «bujqësia është uzinë pa çati». Parashikimet e kooperativistëve janë të mbështetura në baza reale, po sidoqoftë në bujqësi, nëpër ara, nuk vepron vetëm dora e njeriut. Forcat e natyrës si era, shiu, thatësira në një mënyrë ose në një tjetër kanë efektet e tyre pozitive ose negative. Dhe në kooperativën «Apolonia» kooperativistët e dinë se marrja e zotimeve e hartimi i planit tekniko-organizativ janë vetëm çapi fillestar, kurse përpjekjet në çdo sektor e brigadë për t'i realizuar janë vendimtare. Në betejën për të vënë në jetë planin revolucionar është hedhur në aksion konkret e gjithë masa. Çështja e realizimit të planit është marrë në

dorën e masës. Nuk mendon vetëm kryetari, sekretari i partisë ose përgjegjësit e sektorëve. Të gjithë përpiqen për të prodhuar më shumë e për të thënë diçka të re.

Organizata bazë e partisë dhe kryesia e kooperativës e kanë kuptuar dhe e kanë inkurajuar në kohën e duhur mendimin krijonjës të punonjësve.

Sekretari i partisë dhe kryetari i kooperativës interesohen vetë çdo ditë për eksperimentet. Për ditë shkojnë nëpër ngastrat eksperimentale dhe bisedojnë me brigadierët dhe punonjësit e ugareve. Mësimet e shokut Enver kanë brumosur komunistët dhe masën e kooperativistëve me shpirtin e dashurisë për punën dhe agroteknikën.

MISRI HAMULLOR

Menjëherë mbas korrjes dhe shirjes së të lash-tave fillon fushata e mbjelljes së misrit hamullor. Mbjellja e këtij misri ka për qëllim që të shtojë prodhimin e drithit, si dhe të foragjereve për blegtorinë.

Organizata e partisë në Pojan ka bërë një punë të madhe, për të formuar bindien e kooperativistëve lidhur me nevojën e shtimit të sipërfaqes me misër hamullor.

Sekretari i organizatës së kooperativës, Gori, u shpreh kështu: «Ne e kemi provuar se mbjellja e hershme e misrit hamullor, menjëherë mbas korrjeve, ka dhënë prodhime të mira. Për ta mbjellë misrin hamullor edhe këtë vit sa më shpejt ne së pari përcaktuam planin e punës. Duke u mbështetur në përvojën e viteve të kaluara, pamë se për t'i mbjellë heret hamullore duhej të korrnin dhe të shinin shpejt e pa humbje të lashtat. Për të ndihmuar forcat në fushatën e korrjes, dualën nëpër ara dhe të moshuarit dhe nxënësit e shkollës».

Parulla e ditës është: «Të korrin pa humbur asnjë kalli». Përgjegjësi i sektorit të qendrës, Ndreu, tregon se korrja fillonte me natë deri në orët e para

të mëngjezit. Kur vesa thahej e grurit i thyhej kërcelli, kooperativistët e linin këtë front pune dhe fillonin prashitjen e misrit ose të pambukut. Transportimi i grurit për në lëmë bëhej natën me qerre të siguruara e të lidhura mirë, me qëllim që të mos binin kallinj të rrugës. Sapo mbaronte mbledhja e kallinjve, që mund të kishin rënë rastësisht, fute-shin traktorët për të bërë plugimin e diskimin e hamullores. Ugaret hamullore mbilleshin me misër menjëherë mbas diskimit, për t'u shfrytëzuar sa më mirë vlagu.

Në kooperativën «Apolonia» edhe për misrin hamullor tregohet kujdes dhe i shërbehet ashtu si i shërbehet bimës së misrit kulturë e parë, i cili mbillet në pranverë.

Anëtarët e kësaj kooperative tregohen të gatshëm për shërbimet, që i bëjnë misrit hamullor. Ata janë të bindur për dobinë e tij. Vitin e kaluar në një sipërfaqe të madhe prej më tepër se 150 hektarë hamullore, muarën mesatarisht 17 kv. misër kokërr për hektarë.

Në këtë drejtim rezultatet më të mira i arriti brigada që i ka ugaret e veta në fshatin Sop. Dikur soparakët në parcelat e tyre nuk merrnin as prej misrit kulturë e parë aq sa muarën për hektarë me misër kulturë e dytë. Kjo brigadë në të njëjtën tokë të Sopit brenda vitit mori 28 kv. grurë dhe 24 kv. misër kokërr për hektar d.m.th. 52 kv. të marra së bashku për hektar. Këtë vit prodhimi ka qenë edhe më i madh. Këtë prodhim brigada ja detyron mbjelljes së shpejtë e me cilësi, përdorimit të mirë të plehut dhe rritjes së kujdesit për bimën.

Hyseni, brigadjeri, sado që është bujk i mirë

dhe njeri me përvojë, vjen çdo ditë në qendër të sektorit. Bisedon me brigadjerët e tjerë, shkëmben mendime për mbarëvajtjen e punës.

— Edhe misri hamullor — tregon Hyseni — po të mbillet në rregull, po t'i bëhen shërbimet e duhura, të plehrohet me pleh kimik e organik, jep rendimente shumë të mira. «Mënyrën e plehimit të vitit të kaluar brigada po e shtrin në një sipërfaqe shumë të gjerë. Në afërsi të ugareve hamullor u grumbulluan me kohë plehra organike të përpunuara me superfosfat, pa me ato kushte që u mbajtën për misrin kulturë e parë. Sa mbaronte mbjellja, misri hamullor plehrohej me anë të brazdës, në krye të së cilës është vendosur vaska. Vaskat (gropat), që shpesh janë prej çimentoje, mbajnë brenda kompostot e bëra me plehra fekalesh ose urinën e holluar. Ujët gjatë rrjedhës së tij hyn në vaskë dhe del së andejmi duke marrë me vete plehun e nevojshëm, që ja çon bimës.

Pas ujitjes së parë misrit hamullor i bëhet plehrimi suplementar me nitrat amoni rrënjë më rrënjë. Në rritjen e bimëve bëhen me intervale të përshtatshme dhe dy prashitje e dy ujitje. Kështu punon brigada e Hysen Ballës me misrin hamullor. Vetë Hyseni nuk është agronom me diplomë, po ai e njohu agroteknikën nga dëshira për të shtuar prodhimin. Jeta për atë ka qenë një shkollë.

Kooperativa «Apolonia» duke u nisur nga përvoja e brigadës së Sopit, që drejtohet nga Hyseni, duke e përgjithësuar eksperiencën e kësaj brigade, vendosi të rrisë që këtë vit sipërfaqen e misrit hamullor. Në krahasim me vitin 1967 në vitin 1968

misri hamullor zuri një sipërfaqe 2 herë më të madhe, nga 150 hektarë arriti në 300 hektarë.

Misri hamullor është një rezervë e rëndësishme për shtimin e rendimentit. Ata realizuan parullën: «të marrim në v. 1968 prodhimin e v. 1970».

Në kooperativë misrin hamullor e mbjellin edhe për ushqim për bagëtinë.

NJERËZ TË LUMTUR

Shpesh lexojmë nëpër parulla fjalën: «Nder punës»! «Lavdi punës!» Dashuria për punën në çdo vend e për çdo mjeshtëri është veçoria jonë themelore në ndërtimin e socializmit. Puna, nga një barrë e rëndë siç ishte në të kaluarën, është kthyer në burim begatie. Myzeqarët kurrë s'kanë qenë kaq të lumtur sa sot. Lirinë e fituan me gjak. Begatinë po e rrisin për ditë me djersë. Me punë, e të udhëhequr nga Partia, pojanakët e bënë fshatin e tyre një qytet të vogël bujqësor. Përparimi duket në çdo familje. Një mbrëmje rastisëm të ishim në shtëpinë e xha Kronit, babajt të Lirisë, brigadjeres së dalluar. Kur hymë në oborr e gjetëm ulur në karrike përpara shtëpisë. Sytë i qeshnin dhe fytyra i shkëlqente nga lumturia. Ka arësye xha Kroni ta ndjejë veten aq të kënaqur. Sa herë shikon shtëpinë i vete mendja te kasollja që kishte në buzë të kënetës së Hoxharës. Në atë kasolle të mbuluar me kashtë, ku të pëlcisnin sytë nga tymi, si në vrimë të dhelprës, pati kaluar vitet e varfërisë xha Kroni. Aq i varfër ka qenë xha Kroni, sa që kurrë nuk i bëri dy qe bashkë. Gjithmonë një ka do ta kërkonte me qira te subashi.

Kështu ishte ajo kohë. Punonte Kroni tërë vi-

tin dhe vinte qehajai i merrte të tretën për beun, të dhjetën për shtetin; subashi (pasaniku) i merrte hakën e kaut, që i kishte dhënë me qira. Prifti nga ana e tij donte hakën një brokë (25 kg.) në vit, qi-shari edhe ai donte hakën një karroqe (5 kg.). Taksidari kërkonte të tijat për shtetin. Kroni i shkretë mblidhte supet e psherëtinte. Ja kështu ishte atëhere: prodhoje bukë e haje lakra; të tjerëve, që s'punonin, u mbushje barkun e vetë rrije me gisht në gojë. Kronit dhe shokëve të tij i kishte mbirë në dorë thesi, për të blerë misrin, që e prodhonin vetë në ara. Blinin bujqit atë misër të dëshiruar, që jau merrnin me kuintal dhe e blinin pastaj me karroqe. Sa pak miell kishte në hambaret e familjeve fshatare! Aq pak, sa fëmijët, shpesh, në vend të thoshin: «duam bukë», thoshin «duam lakra, kur do të piqen lakrat në çerep?»

Mjerimi dhe në Myzeqe ishte ashtu si e përcaktonte poetikisht Migjeni: «Një njollë e pashlyeshme në ballë të njerëzimit». Në çdo stinë mjerimi ndërronte trajtat, ngjyrat, por ngelte gjithnjë «në dritëzën e syrit të kërthinit e dridhej posi flaka e mekun e qirinit».

Kur vinte pranvera, natyra këndonte në Myzeqe, po njerëzit rënkonin. Nga që njerëzit nuk e ngopin barkun me bukë, vinin të venitur e të pafuqishëm. Shpeshherë në pranverë fëmijët vdisnin nga vreri i bathës jeshile.

Në ditët e verës malarja, porsi një shtrigë e verdhë, i moliste njerëzit deri sa i çonte para kohe në varr.

Në vjeshtë, pasi mbaronin punët nëpër ara, myzeqarët u suleshin kënetave. Vargane bujqish të kapitur shkonin drejt kënetës për të korrur kashtë.

Kashta u duhej për rrogoza, të cilët ishin vetëmja stromë. Po më shumë se për rrogoza kashta u duhej për të mbuluar çatitë e kasolleve. Futeshin të mjerrët në ujët e kënetës deri në brez, për të mbledhur sa më shumë kashtë, nuk vinin re shushunjat, që u pinin gjakun, kashta ishte e nevojshme si buka.

Ja, atë jetë e sjell ndër mend gjithnjë xha Kroni, kur ulet mbi karrike midis trandafilave. Sot atij i duket vetja si në një përrallë në mes të asaj lumturie familjare.

Atë mbrëmje gruaja e tij, nënë Vera, bënte kafënë në furnellë elektrike, Manda, vajza e madhe, ziente gjellën në furnellë vajguri, nusja, Drita, hekuroste rrobat me hekur elektrik. Djali i madh, Sokrati, që është drejtor i shkollës 8-vjeçare, s'ka ardhur akoma nga shkolla e natës.

Kur flet radjoja, xha Kroni rri dhe e dëgjon, pa kur fillon ndonjë këngë myzeqare, ai i afrohet radjos dhe bën iso «eee». Më shumë i pëlqen kënga.

«Të dalim nga Myzeqeja

Të shohim tokat e reja».

Vitet e mëparshme, ditë e natë te vajzat e kishte patur mendjen xha Kroni. «Çupa është si qelqja, delikate — thoshte ai — çupa është derë e botës, andaj duhet ruajtur mirë, se të mbetet pleh në shtëpi». Kështu mendonte ai, ndonse e dinte që vajzat e tij ishin flori, mendimet e vjetra edhe atë e mundonin. Si çdo njeri edhe Xha Kroni kishte pikëpamjen e vet për gruan, për femrën. Kishte dhe ai atë pikëpamje, që i kishte lënë i gjyshi, i ati dhe **më të vjetrit. «Gruaja duhej të punonte brenda për brenda shtëpisë, fundja mund të shkonte edhe në kopsht, po jo të punonte me burrat. Po të takonte rrugës burra, gruaja, vajza, femra duhej të ulte ko-**

kën dhe të përshëndeste pa shikuar njeri me sy». Kështu mendonin gjithë burrat në të kaluarën.

Dhe në Myzeqe sundonte mendimi se në shtëpi duhet të këndojë gjeli e jo pula. Në këtë mënyrë, me këto ligje të pashkruara, forca e zakonisht rregullonte marrëdhëniet midis burrave dhe grave. Kjo psikologji me këto zakone qenë shenjtëruar brez pas brezi. Rriteshin gjeneratat duke thithur si qumështin e nënës ligjet e errëta, që i mbronte injoranca dhe i bekonte prifti. Kron Çullhaj, megjithëse është nga njerëzit e përparuar për moshën e tij, nuk ishte fare i çliruar nga bota e vjetër. I thanë dhjetë vjet më parë Kronit: «vajzën tënde, Marijen, do ta marrim llogaritare në zyrat e kooperativës». Xha Kroni tundi kokën dhe tha: «Jo, jo, nuk bën dot ajo, është e padalë». Këtë thoshte me gojë, po në kokë i vërtiteshin mendimet e vjetra se gruaja nuk duhet të punojë midis burrave, se vajza është delikate. I thanë për së dyti, po Kroni kundërshtoi: «Jo, jo se bie defiçit vajza». Ai s'pranoi as për të tretën herë. Marija pa marrë parasysh mendimet e babajt pranoi të futej llogaritare. Ajo u bë llogaritare e zonja. Marija që nga fluturat e para të Pojanit që tregoi se vajzat punojnë si djemtë dhe më mirë se ata. Vitet kaluan, jeta po shkonte e bashkë me të gjithë ndryshonte dhe Kroni. Vendin e dyshimit dhe të druajtjes po e zinte besimi dhe vendosmëria. Që ishte zgjuar e rritur një Kron i ri brenda xha Kronit të vjetër, e kuptuan të gjithë në familje dhe në fshat. Kjo gjë u duk kur u nis vajza e dytë, Manda, për të mësuar në shkollë të mesme. U bë sportiste Manda, vraponjëse, volibolliste. Manda u zgjodh anëtare e komitetit të fiskulturës për rrethin, po xha Kroni nuk i doli më prag, nuk thotë më asnjë gjysëm fjale, nuk i quan më vajzat «qelqe delikate».

V E R A

Aq të gëzuar sa Kroni e ndjen veten dhe e shoqja e tij, Vera. Nga e kaluara ajo s'do të mbajë mend asgjë. Veç një kujtim i hidhur ja lëndon zemrën, kujtimi për fëmijën e parë, Trifonin, që i vdiq në lulen e jetës. Djali vuante nga malarja. Për t'i hequr të ligën u endën nëpër yshtare. Asnjë përmirësim nuk pati fëmija.. Muarën në dorë dy pulat e vetme dhe shkuan në Fier për ta vizituar te doktori. Shtrenjtë e paguan doktorin. Për të blerë ilaçet duheshin kërkuar para borxh. Kur u kthye Kroni me paratë e gjetura borxh, Vera po qante me dënësë. Djali kishte vdekur. Ilaçet nuk u blenë, por ato para Kroni nuk i ktheu, se i duheshin për varrim. Kështu ishte ajo kohë, njeriu nuk ngrysej si gëdhihej. Vera na tha vetë:

— Sot s'ka më sëmundje si atëherë. Dhe po u sëmur njeriu, shërohet pa mundime. Të rrojë Partia dhe Enveri që i shpëtojnë njerëzit falas. Këtë vit — vazhdon Vera të flasë — pata të shtruar në spital vajzën e vogël, Arsinonë. Mjekët me ilaçet më të mira ma shëruan dhe ja tek është shëndoshë si molla.

Edhe nëna Vera është përtërirë shpirtërisht. Ajo

s'kërkon më nga fëmijët të zbatojnë zakonet prapanike të kohës së parë. Nuk i tha gjë djalit, që e zgjodhi vetë nusen e re sykaltër, Dritën, të cilën nuk e mendojnë kurrë me rregullat e vjetra të nusërisë. Vera nuk u bë pengesë për Mandën, kur u fejua me dashuri. Në rregullimin e tavolinës dhe të guzhinës Vera si të gjitha gratë pojanake, ka shkuar përpara. Në shtëpinë e saj nuk hanë më bukë ulur në rrogoz, po në tavolinë, me pjatë dhe priunj të veçantë. Në familjen e Verës çdo gjë e vjetër i ka lënë vendin së resë. Të gjithë flenë në krevate, të gjithë pinë me gota ujini dhe jo me shtëmbë.

NË SHTËPINË E RRAPOS

Në shtëpinë e Rrapos na bëri përshtypje dhoma e pritjes, karrikat me llustër, tavolina e rrumbullaktë, albumi fotografik. Ne bisedonim dhe radjoja këndonte:

«Të shkëlqente djersa mbi faqe si ar,
Djalo myzeqar».

E shoqja e Rrapos, Ana, tregoi shumë gjëra. Ajo foli edhe për fejesën e saj «Qemë fejuar, po s'ishim parë. Burri më pati parë një herë që pas gardhit, po unë s'mund ta përfytyroja. T'ju thoshja shoqeve këtë dëshirë s'mundja, ishte turp». Në këto e sipër erdhi një djalë e i tha vajzës së Rrapos:

— Ndone. telefoni.

Vajza ja la së jemës kafënë në plitkë dhe iku.

— Ikën me nxitim — tha dikush — se e kërkon i fejuari.

— Më shumë se dy ditë s'vonon t'i bjerë telefonit dhëndrri. Java shtatë dhëndrri tetë — tha Ana me shaka.

— Po pse i thonë fejesë me dashuri — foli Rrapua — apo do si në kohën tënde, që ta shohë që pas gardhit e të martohet pa u njohur.

— Ajo kohë mos ardh të kurrë — tha Ana.

Me dashuri, pa asnjë lajmësi po martohen kudo në Myzeqe. Të rinjtë në punë njohin njëri-tjetrin, miqësohen dhe vendosin vetë për jetën bashkëshortore, veprojnë ashtu si u thotë zemra.

Ndoneja erdhi vrap në shtëpi.

— Si ishte dhëndrri? — pyeti Rrapua.

— Mirë, u bën të fala, vjen të shtunën. — Kaq tha ajo dhe, si veshi pantallonat, u nis për në punë.

Në ara, si gjithë vajzat e tjera, ajo shkon me pantallona. Në fillim edhe në kooperativën «Apolonia» kishin turp vajzat të vishnin pantallona. Tashti ndodh e kundërta, po të shkosh në ara për punë me fustan, pa pantallona, të qeshin.

Përparimet në jetën e kooperativistëve të kooperativës së bashkuar «Apolonia» janë rezultat i ngritjes së mirëqenjes materiale.

Nga ana tjetër duhet thënë se edhe ngritja e mirëqenjes vetë ka ardhur si pasojë e shtimit të prodhimit. Kjo kooperativë sot është një ekonomi e fortë, që ka gjetur stabilitet. Me këtë duhet të kuptojmë se edhe kur kushtet natyrore nuk janë të favorshme, kjo ekonomi e madhe nuk ka ulje të prodhimit.

Në intensifikimin e prodhimit kanë ndikuar shumë faktorë si p.sh. organizimi i mirë i punës, futja e agroteknikës së përparuar, zgjerimi i sipërfaqes së punueshme. Po faktori më vendimtar janë vetë njerëzit, kooperativistët, të cilët janë të bindur se vetëm me duart dhe mendjen e tyre e transformojnë natyrën dhe në të njëjtën kohë nëpërmjet procesit të punës transformojnë vetëveten.

Shtrirja e arësimit dhe futja e kulturës në masat e gjera ka ngritur në një shkallë të lartë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të detyrës. Shumica e të

rinjve kooperativistë kanë mbaruar shkollën 8-vjeçare. Një pjesë e madhe e kooperativistëve vazhdon shkollën masive me programe të reduktuara pa u shkëputur nga puna.

Një anë tjetër që duhet përmendur në jetën e brendshme të kësaj kooperative është kombinimi i interesave imediate me ato të perspektivës. Kjo gjë shprehet në rritjen e fondeve themelore në ekonomi nga 10% në 17% këtë vit. Nëpërmjet këtij fondi do të shtohen edhe përmirësohen brenda një kohe shumë të shpejtë kopshtet e fëmijëve, çerdhet, vatrat e kulturës, stallat e bagëtive, hangaret e drithit.

BUJQËSI ME ÇATI

Jemi në një repart të bujqësisë me çati. Jemi futur në sera. Ato janë disa dhoma të gjata si hangare, të ndërtuara me mushama transparente. Kjo mushama e hollë, e tejdukshme shërben si mur rrethonjës edhe si çati. Brenda këtyre dhomave transparente kultivohen perimet e hershme. Kështu ka lindur edhe në rrethin e Fierit një mjeshtëri e re bujqësore, një bujqësi me çati.

Ferma «Çlirimi» ka dhjetë dynym tokë në sera. Dhjetë dhoma të një uzine të gjelbër bujqësore me mur dhe çati transparente.

Serat kanë shumë sekrete për njerëzit që s'kanë punuar me to. Ato e habisin vizitorin, po nuk i pati njohur.

Para se të flasim për serat, le të njihemi me një specialiste të re, që punon aty. E quajnë Vjollca. Ajo është agronome e mesme. Akoma është shumë e re. Flokët e arta i bëjnë kontrast me sytë e zes. Ka mbaruar teknikumin bujqësor dhe është specializuar për perime. Detyra e Vjollcës është sa delikate, aq edhe interesante. Vjollca, kur spjegon për serat, flet ngadalë dhe e qetë:

— Serat — tha ajo — formojnë një sektor të

rëndësishëm për bujqësinë tonë. Sado që ato janë në fazën fillestare, janë bërë një ndihmë e madhe për ekonominë tonë. Me anë të serave sigurojmë domate para kohe. Sot për sot ngrohja e ajrit brenda në sera bëhet vetëm me anë të rrezeve të diellit. Nesër, kur energjia elektrike do të futet gjerësisht edhe në bujqësi, serat do të kenë një të ardhme të shkëlqyer. Me anën e saj do të krijohen sisteme të posaçme ngrohjesh për serat. Nuk është e largët dita, kur me serat tona do të prodhojmë pa dalë mirë dimri domate, sallatorë; kunguj siç i prodhojmë sot në kopshte. Njeriu do t'ja kalojë natyrës, do të dalë dy tre muaj më përpara. Vjollca tregoi shumë gjëra të reja rreth punës në sera.

Toka, mbi të cilën ngrihen serat, punohet qilizmë në vjeshtë me traktor. Plugimi i dytë bëhet po me traktor. Në muajin dhjetor ngrihen serat. Ngulen furka prej betoni (shtylla). Mbi këto shtylla vendosen mushamatë transparente, ose, si u thonë ndryshe, cipat **plastmas**. Me këtë mushama plastmas ose polietileni hidhet dhe çatia e serave. Gjatë muajit janar tokës së mbuluar i bëjmë një punim me bel deri 30 cm. thellësi. Pastaj bëhet çapitja me shatë. Lartësia e serave duhet të jetë e tillë, që të mos pengojë në punë njerëzit që futen brenda, d.m.th. të jenë më të larta se një boj njeriu, anash ato vijnë duke u ulur. Kur mbjellim domate kemi parasysh që njëra vijë nga tjetra të jetë 75 cm. larg. Distancat e bimëve duhet të kenë rreth 35 cm. largësi. Në çdo gropë mbjellim një fidan. Fidanët merren nga shtretërit e nxehtë, që quhen nga punonjësit me shaka materniteti i perimores. Në gropë rreth bimës, — spjegon Vjollca hidhet pleh organik e kimik. Hedhim 20 gr. superfosfat e 10 gr. sulfat amoni. Plehu

azotik, nuk këshillohet për serat, se vonon pjekjen. Kujdesin më të madh punonjësit e serave e tregojnë për shërbimet ndaj bimëve. Në radhë të parë kanë parasysh rregullimin e temperaturës. Jashtë temperatura mund të ulet, po brenda duhet siguruar një ambient i ngrohtë pranveror, një temperaturë nga 18 gradë deri 20 gradë mbi zero për ditët me re. Gjatë ditëve me diell temperatura arrin deri në 25 gradë mbi zero. Po që se ajri brenda serave nga shkaku i një dielli të fortë nxehet dhe temperatura ngrihet mbi 28 gradë, atëhere hapen dritaret ose perdet anësore. Temperatura e lartë shkakton rrëzimin e luleve.

— Si sigurohet kjo temperaturë gjatë dimrit dhe në fillim të pranverës?

— Sera i ngjan një tuneli transparent. Në këtë sallon bujqësor të mbjellë hyn ngrohtësia e rrezeve diellore. Ajri ngrohet. Ajri i jashtëm s'futet dot brenda. Në këtë mënyrë grumbullohet nxehtësia e diellit nën çatin e tejudkshme.

Bimët, siç dihet, kanë nevojë për frymëmarrje. Mjeshtërit e kanë parasysh këtë gjë, andaj ata kujdesin nga njëra anë të ruajnë temperaturën e nevojshme të një mikroklimë pranverore dhe nga ana tjetër të rregullojnë qarkullimin gradual të masës së ajrit nga jashtë brenda. Vërtet duket gjë interesante: Rreth e qark serave fryn erë, bën të ftohtë, është dimër, kurse brenda tyre gjelbërojnë domatet me lule.

— Po gjatë natës, kur ulet temperatura e ambientit, ç'ndodh? Natyrisht edhe brenda serave ngrohtësia bie, por prapë ajo është më e lartë se temperatura e ambientit. Me një fjalë, ndërsa jashtë kemi natën e ftohtë dimërore, brenda në sera është

freskia e natës pranverore. Një gjë e tillë spjegohet me arësyen se nxehtësia e thithur nga ajri gjatë ditës rezervohet brenda dhe për natën. Sera, pra, ashtu si ngrohet ngadalë, ashtu dhe do të ftohet ngadalë.

Një javë mbas mbjelljes domateve u bëhet prashitja. Prashitja e parë lot një rol të rëndësishëm: ajris tokën, e ngroh atë dhe e pastron nga barishtet e këqia.

Ujitja e bimëve brenda serave bëhet me bidona e jo me vaditje të rrjedhshme. Domatet mbas shatës së parë hedhin shtat, andaj ato duhen mbajtur të drejta, të mos koloviten e të shtrembërohen. Për këtë shkak mbas çdo bime vendosen hunj kallamash, pas të cilëve lidhen domatet me një mënyrë të atillë që të mos vriten e të ndrydhen.

Kur domatja i shton shumë degët, punëtorët futen brenda, i shikojnë një më një bimët e u heqin degëzat e tepërta, se i thithin kot ushqimin bimës e nuk vlejnë për kokrra, nuk çelin lule.

Për ta mbrojtur domaten nga sëmundjet i bëhet spërkatja me një solucion, që quhet **aspar** ose **zinep**.

Kur domatet arrijnë fazën e parë të pjekjes, u bëjnë vaditje me ujë të rrjedhshëm. Prej kanalit vaditës të parcelave ujët hyn në bradzën e serës dhe pastaj shpërndahet nëpër gjithë rrënjët e domateve.

— Puna në sera — tha agronome Vjollca, kërkon djersë, kujdes e shpenzime, por të ardhurat janë aq të mëdha, sa i tejkalojnë investimet dhe sigurojnë fitime të mira për ekonominë tonë. Tregu i brendshëm dhe tregu i jashtëm pret me padurim domatet e hershme të serave. Në serat tona domatet janë të mbushura plot.

Kështu në guzhinat tona edhe për muajt e parë

të periudhës së ftohtë do të ketë domate të freskëta, të cilat janë shumë të përshtatshme edhe për turshi.

Së shpejti rritja e domateve dhe e perimeve të tjera në sera do të përhapet shumë. Klima e vendit tonë është e përshtatshme dhe favorizon rritjen e kulturës së domates në sera. Jo çdo ditë dimri është me re, ka dhe ditë me diell, pastaj jo çdo ditë dimri me re është fare pa diell. Ai diell është i mjaftueshëm për të siguruar procesin e fotosintezës.

LOPËT LARAMANE

Blegtoria është motër e bujqësisë, të dyja ndihmojnë njëra-tjetrën dhe andaj duhet të ecin përpara në mënyrë të harmonizuar. Kongresi V i Kooperativave bujqësore porositi: «ta ngarkojmë tokën me një numër akoma më të madh lopësh». Rezultatet më të shkëlqyera në rrethin e Fierit për shtimin dhe përmirësimin e racës së lopës i kanë arritur punonjësit e NBSH «Çlirimi». Si kudo edhe në këtë ndërmarrje bujqësore punonjësit e blegtorisë punojnë pa u kursyer që të shtojnë numrin e krerëve dhe të përmirësojnë racën e tyre.

Rritja e numrit të krerëve dhe përmirësimi i racës janë dy rrugët kryesore, që do të shpien më përpara blegtorinë tonë socialiste.

Zmadhimi i tufave të bagëtisë dhe përmirësimi i racës janë të lidhura drejt për së drejti me shtimin dhe intensifikimin e bazës ushqimore. Në NBSH «Çlirimi» punohet në mënyrë sistematike dhe këmbëngulëse për sigurimin e bazës ushqimore të blegtorisë. Kujdes tregohet si për bimët foragjere të para, si edhe për bimët foragjere me cikël të shkurtër vegjetativ, që lejojnë mbjelljen e dy ose më shumë bimëve brenda vitit.

Si pasojë e punës së kujdesshme dhe e rritjes së bazës ushqimore, qumështi në sasinë globale ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit.

Në vitin 1966 muarën 3401 litra qumësht për çdo lopë foragjere.

Më 1967 mezararja e qumështit për çdo lopë u rrit në 5324 litra. Për vitin 1968 u zotuan të marrin 3600 litra qumësht për çdo lopë foragjere.

Ky ishte zotimi «zyrtar» për vitin 1968, por nga goja e mjelëseve dëgjova se synohet të merren 3700 litra për çdo lopë.

Këto shifra janë shprehje konkrete e një pune këmbëngulëse për të intensifikuar prodhimin e qumështit dhe nënprodukteve të tij.

Në NBSH «Çlirimi» dëgjon fjalët më të mira për mjelëset e rendimenteve të larta, që marrin mezararisht nga 3600 litra për çdo lopë foragjere. Më e njohura ndër gjithë mjelëset është Vita, e cila arrin të marrë deri në 45 litra qumësht në ditë nga çdo lopë.

Punonjësit e sektorit të blegtorisë në NBSH «Çlirimi» po përpiqen që përvojën e fituar nga tufa e rendimenteve të larta ta shpërndajnë në çdo tufë.

Lopët e fermës janë të lindura në Shqipëri. Ato u rriten e u mësuan nga stalljerët tanë, nga mjelëset tona. Këto lopë kaq qumështore janë fryt i zooteknikës sonë, ato janë një shembull i gjallë, që tregon se në vendin tonë lopa do të ketë një të ardhme të ndritur.

MJELËSET

Pasioni për punën si kudo dhe në blegtori bën çudira. S'ka kënaqësi më të madhe për një njeri që merret me bagëti se ajo që ndjen kur merr 40 ose 50 litra qumësht për çdo lopë foragjere në ditë. Që të bindesh për këtë, duhet të shkosh në stallë, të shikosh si punojnë mjelëset, ç'vemendje tregojnë ato për çdo proces pune.

Vita, Zoica e Xhevairja janë mjelëset e asaj tufe që quhet tufa e rendimenteve të larta. Ato mbajnë në stallë një pastërti shembullore. Si janë të pastra vendet e pushimit të lopëve në stallë, ashtu janë edhe vetë lopët. Çdo ditë i fërkojnë dhe i pas-trojnë. Secilës lopë, para se ta mjelin, i lajnë gjirin me ujë të freskët, po kështu edhe pas mjeljes.

Vita, Zoica e Xhevairja as nuk lodhen e as nuk mërziten kur mjelin me dhjetëra litra qumësht. Mjelëset e dinë se lopët të duan të jesh e gëzuar, e qeshur, t'u flasësh me përkëdhelje. Duket si e çuditshme, por lopët i njohin mjelëset e miça, i duan dhe ua japin të gjithë qumështin. Mjelëset kurrë nuk dinë t'u hakërrohen lopëve, ato vetëm i ledhatojnë me fjalë ose me dorë.

Mjeshtre të vërteta në profesionin e tyre janë këto tri mjelëse veçanërisht për ushqimin e lopëve. Ato mundohen që ushqimi të jetë i një cilësie të mirë dhe i sasisë së mjaftueshme, me qëllim që të ruajnë shëndetin e lopëve e të marrin sa më shumë qumësht.

EKSPERIMENTIMET

Ushqimin e gjelbërt e hanë me shije dhe e tretin shpejt, andaj kafshët e presin me uri. Shtalljerët nga dëshira për të ushqyer sa më mirë lopët, ua mbushnin grazhdin plot. «Do të marrim më shumë qumësht» thoshin mjelëset. Po pikërisht në këtë periudhë tranzitore, në fazën e kalimit prej ushqimit krejt të thatë në ushqimin e gjelbërt, lopët hiqeshin nga shëndeti. Të gjitha i kapte diareja. Lodheshin shtalljerët, mundoheshin mjelëset ditë e natë për pastërti, për të ruajtur kushtet higjienike si të ambientit ashtu edhe për trupin e lopëve, por puna nuk u kishte duk. Qumështi pakësohej. Mjelëset u shqetësuan.

Tek pastronin bisedonin me njëra-tjetrën.

— Ç'do të jetë shkak i diaresë — pyeti Zoica — qumështi na u pakësua, lopët u tëhollën.

— Unë mendoj se kjo e keqe shkaktohet nga ushqimi i gjelbërt — tha Vita.

— Vërtet, sa kohë që nuk patëm filluar nga ushqimi i gjelbërt, nuk patëm as një lopë me diare — foli Xhevairja.

— Po të bëjmë një provë — tha Vita.

— Ç'provë, mendon?

— Ja ç'mendoj unë: një lope për çdo grup t'i japim ushqim të njomë përzier me të thatë. Të shikojmë se çfarë rezultati do të ketë — propozoi Vita. — Vetëm se duhet ta përziejmë mirë ushqimin e thatë me të njomin, me qëllim që lopët ta hanë e të mos kenë mundësi të zgjedhin masën e gjelbërt e të lënë kashtën e thatë — foli Xhevairja.

Pas tri ditësh mjelëset vërejtën me kënaqësi se lopët, të cilat kishin ngrënë bar të njomë, të përzier me kashtë të thatë, nuk kishin më sëmundjen e diarresë. Të gëzuara e pa asnjë druajtje ato ja thanë këtë zooteknikut të sektorit, i cili e studjoi dhe u tha mjelëseve:

— Prova juaj ngjan e thjeshtë në dukje, por ajo është fillimi i një eksperimenti me rëndësi shkencore. Jam i mendimit ta shtrijmë eksperimentin në të gjithë tufën e rendimentit të lartë.

Të trija vajzat e pritën me gëzim propozimin e zooteknikut, për ta shtrirë eksperimentin në të gjithë tufën e lopëve.

Qëllimi i këtij eksperimenti ishte: «neutralizimi i lagështirës së njomishteve me ushqime të tjera të thata, për të kompensuar mungesën e lëndës së thatë në ushqimin e gjelbërt».

Jonxha ose tërfili përzihet me kashtë e pastaj grihej. Kështu një pjesë e lagështirës thithej prej kashtës së grurit, dhe kashta nga ana tjetër, bëhet më e tretshme. Grirja dhe përzierja rregullohej në mënyrë që lopët nuk mund ta veçonin njërin ushqim nga tjetri.

Eksperimenti u realizua në tri grupe me veçori të barabarta në të gjitha drejtimet.

Grupi i parë ishte i Xhevaires. Lopët e këtij grupi hanin vetëm hasëll. Vita kishte grupin e dytë.

Lopët e saj hanin hasëll dhe 1.5 kg. kashtë gruri. Lopët e grupit të tretë, për të cilat kujdesej Zoica, hanin hasëll të përzier me tre kg. kashtë gruri. Përzierja e ushqimit bëhej me makinë grirëse silazhi.

Rezultatet e eksperimentit qenë të mrekullueshme.

Së pari, u evitua diareja.

Së dyti, u kursye masa e gjelbërt, duke u zëvendësuar pjesërisht me kashtë të thatë. Sasia e ushqimit të njomë, që ngelej pa u konsumuar, thahej e kthehej në ushqim rezervë për dimër. Ky ushqim i thatë është i një cilësie më të mirë se kashta e grurit dhe lëpushka e misrit.

Së treti: u rrit rendimenti i qumështit. Kjo është ana më e rëndësishme e eksperimentit.

Grupi i parë i lopëve, grupi i Xhevahires, që hante vetëm hasëll, dha një sasi qumështi që u muar si njësi bazë me masën 100%.

Grupi i Vitës, i cili hante hasëll të përzier me kashtë dha 5% më shumë se grupi i parë.

Grupi i tretë, që ishte i Zoicës, lopët e të cilës hanin hasëll të përzier me 3 kg. kashtë të thatë, pati rendimentin më të lartë të qumështit, 109% d.m.th. 9% më shumë se sa grupi i parë.

Ky eksperiment u bë në vitin 1967. Rezultatet e këtij eksperimenti u bënë të njohura në të gjitha mjelëset dhe shtalljerët.

Tabela e eksperimentit.

| Grup | Ushqimi | | |
|-----------|---------|----------------|-------------|
| | Hasëll | Kashtë e thatë | Qumësht në% |
| Grupi I | Hasëll | — — | 100% |
| Grupi II | Hasëll | 1.5 kg. | 105% |
| Grupi III | Hasëll | 3 kg | 109% |

EKSPERIMENTI I DYTË

Dhe eksperimenti i dytë u krye në tufën e rendimenteve të larta. Vita, Xhevairja dhe Zoica qenë ato që hodhën dritë së pari në rrugën e këtij eksperimenti. Askujt nuk i vinte mendja për këtë eksperiment. Edhe vetë mjelëset nuk kishin parë e dëgjuar. Ideja për këtë medim të ri lindi në këtë mënyrë:

Pranë stallave ishin parcelat e mbjella me lakër të bardhë. Si u vualën kokat e lakrave, gjethin dhe kërcellin e tyre ua hodhën lopëve. Sasia e qumështit u shtua në mënyrë të dukshme. Kjo u tërhoqi vëmendjen vajzave. Ato biseduan përsëri me njëra-tjetrën. Ja bënë të njohur zooteknikut të sektorit dhe shokëve të drejtorisë.

Ideja e mjelëseve që si një shkëndijë, që u dha flakë mendimeve të kolektivit.

Drejtori tha:

— «Duhet parë me seriozitetin më të madh mendimi i mjelëseve».

— Do ta eksperimentojmë — tha Novruzi, krye-zootekniku i ndërmarjes.

Tema e eksperimentit të ri ishte:

«Zëvendësimi i pjesshëm i hasëllit me lakër të bardhë».

Qëllimi i eksperimentit qe për të parë se sa e dobishme ishte lakëra foragjere. A e shtonte me të vërtetë rendimentin e qumështit?

N.B.SH. «Çlirimi» mbillte çdo vit nga 450 ha hasëll; edhe pse mbillej kaq shumë ai lopëve nuk u mjaftonte. Nga ana tjetër thatësia lagështia e ngricat e vjeshhtës e të dimrit e dëmtojnë hasëllin dhe rrezikohet kështu baza ushqimore. Lakra foragjere është mjaft rezistente, sidomos gjatë stinës së dimrit, kur ndihet më tepër nevoja për ushqim të freskët.

Mjelëset e tufës së rendimentit të lartë, Vita, Xhevairja e Zoica qenë zbatonjëset e eksperimentit të dytë. Lopët u ndanë prapë në tri grupe me veçori të barabarta.

Grupi i lopëve të Xhevaires, i cili u ushqye me hasëll dhe silazh, dha një sasi qumështi baraz me njësinë 100%.

Grupi i dytë, që hëngri hasëll silazhe dhe lakër, të cilën s'e kishte grupi i parë, dha 18.7% më shumë se grupi i parë. Grupi i tretë, që u ushqye me lakër dhe silazh gjatë kohës së eksperimentimit (që nuk hëngri hasëll): dha 11% më shumë se grupi i parë dhe 7.7% më pak se sa grupi i dytë.

Siç shihet grupi i dytë, që u ushqye me lakër, hasëll edhe silazh pati rendimentin më të lartë se dy grupet e tjera.

Studimet nuk u ndërprejnë me kaq. U studjua dhe kostua e prodhimit të lakrës foragjere.

Nga studimi kolektiv e i hollësishëm u pa se lakra foragjere vërtet ka shpenzime, po të krahasohet me hasëllin, por dobia e saj është aq e madhe, sa ajo i mbulon shpenzimet dhe jep përfitime të mira. Mjafton të kujtojmë shtimin e qumështit.

Këto dy eksperimente, që kishin për qëllim in-

tensifikimin e prodhimit blegtoral, u vunë në jetë nga mjelëset e thjeshta dhe të zgjuara, nga ato punonjëse që janë në vijën e parë të prodhimit.

Dhe Vita, Xhevairja me Zoicën janë një pohim tjetër i vërtetë, që ilustron fjalët e shokut Enver Hoxha se revolucionin tekniko-shkencor si çdo revolucion do ta bëjnë masat e gjera.

Një tjetër provë e dalë nga praktika e prodhimit është nxjerrja e një ushqimi të ri për kafshët, gjetnja e silazhuar e patates. Kjo gjë i vajti së pari në mendje një punonjësi të thjeshtë, Xhemalit. Gjethen e patates lopët nuk e hanë me shije, kur është e pasilazhuar.

«Sikur ta përpunojmë — u tha Xhemali shokëve — ndoshta do ta hanë më mirë lopët».

Kur ushqimi doli i përpunuar lopët nuk i bënë naze. Ushqimi i ri u bë i njohur në të gjithë sektorët e ndërmarrjes.

Sot tonelata të tëra gjethesh e kërcell patatesh mblidhen e silazhohen. Ato mblidhen atëhere kur kokrrat e patates janë rritur dhe s'e ndjejnë më nevojën e tyre.

Kjo «shpikje», ndonëse e thjeshtë, ndonëse duket e zakonshme, përmban në vetëvete një leverdi të madhe ekonomike.

Së pari: shtohet sasia e qumështit, duke zbuluar një rezervë të re, e cila më parë humbiste kot.

Së dyti: shtohet një lloj ushqimi.

Sa më tepër lloje ushqimesh të jepen aq më mirë është për lopët dhe për rendimentin e qumështit.

Ushqimin e përzier lopët e hanë më mirë, kur ka 80% gjethe patate e 20% kashtë.

Këto janë xixëllonja të revolucionit shkencor në bujqësi e blegtari. Po edhe këto janë të mjaftueshme për të thënë me plot gojën se plugu i revolucionit shkencor do të përmbysë çdo mendim të kalbur dhe do të mbjellë me qindra e qindra mendime të reja.

Gjithë fshatarësia jonë kooperativiste nën udhëheqjen e Partisë po punon me ngulm që të rritet begatia e popullit në Shqipërinë socialiste.

Të ndodhesh midis gjelbërimeve, të shkruash për përtëritjen e tokës dhe të mendimit, për intensifikimin e bujqësisë në Myzeqe, s'mund të rriësh pa përmendur gjigantët e industrisë, AZOTIKUN edhe TEC-in. Oxhaqet duken që larg, tek grisnin gunat e reve dhe u tregojnë kooperativistëve vrullin revolucionar të klasës punëtore, të klasës që udhëheq revolucionin e madh, në rrugën e begatshme të të cilit po marshon kryelartë gjithë fshatarësia kooperativiste.

Tabloja madhështore e zonës industriale të Fierit të bie menjëherë në sy, sapo të hipësh në qafën e Koshovicës. Prej këtej del nitrati i amonit (plehu azotik), që shëndosh tokën. Po që këtu dalin edhe arteriet e atdheut, linjat e tensionit të lartë, ku rrjedh energjia elektrike, ku rreh pulsi i komunizmit...

Të bëhet me të vërtetë zemra mal tek shikon që revolucionin tekniko-shkencor po shoqërohet me elektrifikimin e plotë të vendit. Kjo gjë do të thotë se Shqipëria po shkon me hap luftarak të pandalur drejt komunizmit.

PËRMBAJTJA

| | Page |
|---------------------------------|-------------|
| Përshtypjet e para | 3 |
| Shqipëriat e fushës | 7 |
| Aristeja | 11 |
| Bashkëpunëtorët shkencorë | 14 |
| Miti | 18 |
| Vrull nëpër ara | 21 |
| Misri hamullor | 24 |
| Njerëz të lumtur | 28 |
| Vera | 32 |
| Në shtëpinë e Rrapos | 34 |
| Bujqësi me çati | 37 |
| Lopët laramane | 42 |
| Mjelëset | 44 |
| Eksperimentimet | 46 |
| Eksperimenti i dytë | 49 |

49403

BIBLIOTEKA E SHITËRIT
SHKENCOR